- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë

mbetur të përealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprente punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Emri i Autoritetit Kontraktues: Komuna e Rahovecit me adresë në rrugën "Xhelal Hajda – Toni" të cilën e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit: Jetulla Kabashi dhe Emri i Kontraktuesit: N.N.T. "ETNIKU" me adresë në Suharekë, të cilën e përfaqëson Tahir Bugari & "H & B Consulting" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Gazmend Murati & N.N.P. "B – ENGINEERING" me adresë në Suharekë, të cilën e përfaqëson Betim Mamaj janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë: TITULLI I KONTRATËS: NDËRTIMI I QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE - EMERGJENCA - FAZA E DYTË Numri i Prokurimit: 623-18-6656-5-1-1 Numri i Brendshëm: 623-18-052-5-1-1
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	10% i ndalet një vit pas pranimit teknik të punimeve. Pagesa e shumës së ndalur në emër të sigurimit të punimeve (10%) mund të i paguhet: Operatorit Ekonomik me : a. Vendim të Kryetarit të Komunës për leshimin e pageses së 10% të ndalur në emër të sigurimit të punimeve dhe b. Nese OE e sjell garancionin nga ndonjë kompani e licencuar e sigurimeve ose nga ndonjë bankë (për periudhën për të cilën edhe është ndalur 10%). Pagesat kontraktuesit do t'i bëhet në bazë të raportit të organit mbikqyrës.
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [5] ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Organi Mbykqyrës është: Inspektimi dhe testimi bëhet konform kushteve të përgjithshme të kontratës.
Fillimi i punëve	10.1	Punët do të fillojnë brenda Pesë [5] dite pune pas ftesës nga autoriteti kontraktues përkatës nga ana e organit mbikqyrës ose menaxheri i projektit. Ftesa për fillim të punëve do të bëhet me krijimin e kushteve atmosferike.
	10.2	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonësve të lejuara nga organi mbikqyrës. Kontrata është: 24 muaj.

Përmirësimi i defekteve	13.1	Periodha garantuese e defekteve është: 12 muaj.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: Sipas Kushteve të përgjithshme të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë/realizoj ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, punëdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.
Parapagimi	20.1	Shuma e Parapagimit është: 10% të vlerës së kontratës = 48,691.53 €, sipas Ligjit Nr. 06/L-020, paragrafi 4. LIGJI Nr. 06/L-020 PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2018 Neni 13- Pagesat e paradhënies, pika 1. thotë: 1. Organizatat buxhetore mund të paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në pesëmbëdhjetë përqind (15%) të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë e paradhënies mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetë mijë (10,000) Euro, e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. Për pagesën e paradhënies për projektet kapitale, kontrata duhet të përmbajë garancionin e performancës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë. Orari i pagesës: Në dorëzimin e situacionit të parë, pagesa do të ndalet në 30 % i shumës së parapaguar: 14,607.46 € , Në dorëzimin e situacionit të dytë, pagesa do të ndalet në 30 % i shumës së parapaguar: 14,607.46 € , Në dorëzimin e situacionit të tretë, pagesa do të ndalet në 40 % i shumës së parapaguar: 19,476.61 € . për punët që duhen të kryehen para se të bëhen pagesat.
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: N/A
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës = 48,691.53 €, për kohëzgjatjen e periudhës prej: [24 muaj + 30 ditë].
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve. Pagesa do të bëhet vetëm për punët e përfunduara sipas raportit të organit mbikëqyrës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Autoriteti kontraktues cakton departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Gjakovë – Dega Rahovec] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Paramasa dhe Parallojaria
Ndërtimi I Qendrës Kryesore të Mjekësis Familjare - Emergjencia
B + P + 1
K.K. Rahovec



1.1. PUNËT E FASADËS					
	Përshkrimi i pozicionit	Njesia	Sasia	Çmimi	Totali
1.1.1	Furnizimi dhe punimi i fasades termike, me stiropor 8cm Isomaster EPS 100 me rezist. ndaj shtypjes 80 kPa, me depertueshmëri të kaluar të nxehtësisë (λ_0) 0.035 W/mK. Përparësia e tyre është se eliminon urën e nxehtësisë. Rrjeta Mastarnet (qelqi) rezist. ndaj materieve alkalike, dhe e cila përdoret për përforcim të Thermomaster sistemeve fasadore të izolimit, harxhimi i materialit 1.1m2/neto m2, e llojit 160 g/m2. Ngjitës për fasada Thermomaster Fix. Është ngj. me çimento me shtesë rrëshirë artificiale dhe përdoret për ngjitje EPS dhe XPS të pllakave tek sistemet termoizoluese të fasadave dhe ngjitjen e rrjetës qelqore. Tipla Thermomaster D. Tipla është me mburojë qarkore nga poliamidi me goxhdë plastike, me fiksion mekanik (goxhdim) i pll. termoizoluese. Në m2/8 copë tipla me diametër të vrimës 10mm, dhe gjatësi 14-16mm, fuqia e shkëputjes nga muri 0.08kN. Profilët e aluminit në këndet e fasadës nga Thermomaster UZ dhe UL profile. Gjerësia e tyre nga 2-12cm. Nënshtrësa (baza) Corastrend është lëng i koncentruar sistetik dispensues. Kjo nënshtrësë ndalon lagështinë dhe rrit shprehjen e fasadës. Fasada do jetë nga prodhuesi Corastrend me frakcion (granulacion) 2mm. Fasada është elastike me ngjyrë plastike dhe rezistues ndaj kushteve atmosferike dhe rrezeve UV. Ndërsa çoku do punohet nga dogamimi plastik. Ky material mund të zëvendësohet nga një material me karakteristika të ngjajshme.	m²	1,350.00	16.00 €	21,600.00 €
1.1.2	Furnizimi me material dhe punimi i dekorëve rreth dritareve me stiropor dhe fasadë frakcion 2mm pa strukturë.	m²	360.00	3.00 €	1,080.00 €
1.1.3	Furnizimi si dhe montimi i Fasades ventiluese me ngjyrë të hirtë	m²	245.00	55.00 €	13,475.00 €
1.1.4	Furnizimi si dhe montimi i Fasades ventiluese me ngjyrë krem	m²	90.00	55.00 €	4,950.00 €
TOTALI POSICIONI 1.1:					41,105.00 €
1.2. PUNËT E SUVATIMIT (mallterit)					
	Përshkrimi i pozicionit	Njesia	Sasia	Çmimi	Totali
1.2.1	Furnizimi dhe suvatimi i mureve të brendshme me dy shtresë rrafshuese me makinë ose dorë. Suvatimi do punohet nga prodhuesi Renova Renofix 220. Uaç i lehtë me perlit për përpunim të mureve të brendshme. Material i lehtë me perlit në bazë gipsi, për rrafshim të mureve të brendshme dhe tavane. Përdoret si material themelor për patenim (glet) mbi të gjitha bazamentet si tullë, bllok i thjeshtë, bllok betoni, si dhe mbi beton të vrazhdë. Nuk përdoret në sipërfaqe me lagështi. Ka granulacion 0.6mm, trashësia minimale e shtresës rrafshuese është 0.8-10mm, harxhimi 7-8kg/m2/cm, me përçueshmëri të nxehtësisë ca 0.43 W/mK, fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve ca 2.4 N/mm2, elasticiteti pas 28 ditëve ca 1.4 N/mm2. Vlerat e harxhimit janë aproksimative (të përafërta) dhe varën shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit. Ky material mund të zëvendësohet nga një material me karakteristika të ngjajshme.	m²	4,750.00	3.00 €	14,250.00 €
TOTALI POSICIONI 1.2:					14,250.00 €

1.3. PUNËT E NIVELIZIMIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.3.1	Furnizimi dhe punimi i nivelizimit të dyshemeve, që do bëhet me stropor 5cm të prodhuesit Isomaster EPS 70 ose EPS-L70 me rezistencë në shtypje 70kPa dhe përcueshmëri të nxehtësisë (λ) 0.041 W/mK, me rezistencë paradifuzive (μ) 20-40. Kurse rreth fushës nivelizuese do vëndosim stropor 1 cm. Ndërsa shtresa rrafshuese nivelizuese (estrih) 6-8 cm sipas nevojës dhe kushteve të pilakave konstruktive në bodrum, perdhese, kat si dhe shtresa e nivelizimit të kulmit	m ²	3,850.50	4.00 €	15,402.00 €
TOTALI POSICIONI 1.3:					15,402.00 €

1.4. PUNËT E HIDROIZOLIMIT TEK SANITARITË					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.4.1	Furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit të banjove me izolim të ftohtë. Hidroizolimi do bëhet me 3 shtresa nga prodhuesi Masterbit LF (lyerës mbrojtës pa tretës). Është izolim me material me shtresën e materialit plastik, masa tretëse e bitumenit me qëndrueshmëri të lartë në temperatura dhe UV stabil. Koha e tharjes së një shtrese është 2-6 orë, punimi i këtij hidroizolimi bëhet me brushë, valak ose me latuas gjetil. Të punohet sipas specifikimit dhe përshkrimit të prodhuesit. Izolimi do bëhet në dyshemenë e banjove dhe në të gjitha banjot në mure me parapet rreth 100 cm nga dyshemeja. Ndërsa me të njëjtin material do izolojmë pjesën ku ndodhet lavamanet me parapet 120cm nga dyshemeja. Ky material mund të zëvendësohet nga një material me karakteristika të ngjajshme.	m ²	310.00	6.00 €	1,860.00 €
TOTALI POSICIONI 1.4:					1,860.00 €



1.5. PUNËT E PLLAKAVE TË QERAMIKES					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.5.1	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave të qeramikes (me material porcelan ose qeramike). Pllakat do vendosen në banjot e objektit. Montimi i tyre do punohet sipas detajeve projektuese të cilat janë caktuar me kërkesë të arkitektit. Pllakat të cilat do montohen janë me dimensione 45 x 45 cm dhe 33 x 33 cm dhe 40 x 20 me trashësi 0.8cm.. Qeramikat do kenë fuga minimale me gjerësi 2 mm. Pllakat do ngjiten me ngjitës të kualitetit të lartë të prodhuesit ISOMAT. Përzgjedhja e qeramikave do bëhet nga ana e arkitektit projektues.	m ²	1,210.00	14.00 €	16,940.00 €
1.5.2	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave të terases me përzierje të mermert. Pllakat do vendosen në , kaldatore, IT dhe terasë si dhe pllakat e jashtme në rampën për persona me aftësi të kufizuara. Montimi i tyre do punohet sipas detajeve projektuese të cilat janë caktuar me kërkesë të arkitektit. Pllakat të cilat do montohen janë me dimensione 33 x 33 cm dhe me trashësi 1.8cm. Pllakat e terases do kenë fuga minimale me gjerësi 2 mm. E testuar sipas EN 13748-2 E lëmuar për rezistence nga UV me efekt easy clean, ngjyra të përcaktohet nga organin mbikqyrës. Produkti duhet të ketë aditiv kundër kriprave sipas standardit EN. Sqarim : Para vendosjes duhet të sillen qertifikata e prodhuesit dhe atestatPllakat do ngjiten me ngjitës të kualitetit të lartë të prodhuesit Baumit apo të ngjashëm. Përzgjedhja e pllakave do bëhet nga ana e arkitektit projektues.	m ²	600.00	10.00 €	6,000.00 €
TOTALI POSICIONI 1.5:					22,940.00 €
1.6. PUNËT E PARAPETIT TË DRITAREVE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.6.1	Furnizimi me material dhe mveshja e parapetit të dritareve dhe dyerëve të jashtme. Mveshja parashihet të bëhet me memere që do vendosen nga të dyja anët e dritareve, marmëri do jetë me trashësi, T = 2cm. Dhe do caktohet ngjyra sipas kërkesës së arkitektit. (Këtë pozicion mund ta ndërrojmë me mveshje nga llamarinë nga ana e jashtme). Në këtë shumë futet edhe montimi i tyre.	m ²	165.00	8.00 €	1,320.00 €
TOTALI POSICIONI 1.6:					1,320.00 €
1.7. PUNËT E GILINDERAVE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.7.1	Furnizimi dhe montimi i gardhit të shkallëve të brendshme. Gilinderat jenë nga materiali i inoxid.	m ²	45.00	45.00 €	2,025.00 €
1.7.2	Furnizimi dhe montimi i gardhit të shkallëve të brendshme. Gilinderat jenë nga materiali i inoxid të inkastruara në mur.	m ²	45.00	40.00 €	1,800.00 €
TOTALI POSICIONI 1.7:					3,825.00 €
1.8. PUNËT E GRANITIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali



1.8.1	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve me shkelesë terase. Shkallët do mveshën nga pllakat terase, basamiaket me trashësi T=3 cm ngjyrë të hirit ose kafeje, ndërsa anësoret me dogamim plastik me ngjyrë të njëjtë me pjesën tjetër të fasadës.	m ²	101.00	40.00 €	4,040.00 €
1.8.2	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë së rampave, hyrjeve, kthirave dhe holleve, sic janë paraparë në projekt me pllaka terase të mërmerta. Pllakat duhet të jone njeshtresore me trashësi T=2cm ngjyrë të hirit ose kafeje me granulat mërmert.	m ²	206.00	15.00 €	3,090.00 €
TOTALI POSICIONI 1.8:					7,130.00 €



1.9. PUNËT E GLETIMIT (suvatimi me glet)					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.9.1	Furnizimi me material dhe gjetimi i mureve të brendshme. Gjetimi do bëhet në të gjitha sipërfaqet e mureve të brendshme të objektit. Do punohën dy shtresa gjetuese; shtresa e parë është e prodhuesit Renova Renofix 202, është gjet masë në bazë gëlqere për rrafshim. Është masë rrafshuese e rafinuar, jo hidrofobe, me bazë gëlqereje, për rrafshim (patënim). Përdoret për krijimin e sipërfaqeve të lëmuara mbi llaçat themelore. Përdoret për sipërfaqe të mureve të brendshme; paraparaksh të suvatuara me llaç themelor si dhe pllaka gipsi. Struktura e llaçit është gjet mas, me ngjyrë të bardhë, trashësia e shtresës rrafshuese 1-3mm, përqyeshmëria e nxehtësisë 0.3 W/mK, me kapacitet të veçantë të nxehtësisë 1.1/kg K, fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve 1N/mm2. Ndërsa shtresa e dytë rrafshuese do bëhet nga prodhuesi Renova Renofix 206, është gjet masë (llaç i bardhë) për rrafshim (patënim) të mureve të brendshme dhe tavaneve. Është masë rrafshuese finale me bazë gipsi për rrafshim (patënim) paraparaksh të suvatuara (gjetuara) me shtresat tjera rrafshuese. Trashësia minimale e shtresës është 0.1mm, fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve ca. 2.0N/mm2. Këto lloje materialësh të përdorën sipas standardeve dhe rregulloreve të prodhuesit. Ky material mund të zëvendësohet me material të ngjajshëm me karakteristikat e këtyre të cekura më lartë.	m²	4,220.00	2.50 €	10,550.00 €
1.9.2	Furnizimi me material dhe shtresa finale e tratë e gjetimit. Kjo shtresë do punohet nga prodhuesi ScanColor, me finish profesional.	m²	3,750.00	1.00 €	3,750.00 €
TOTALI POSICIONI 1.9:					14,300.00 €
1.10. PUNËT E NGJYRES					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.10.1	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të brendshme. Ngjyra do bëhet nga produkti italian i ngjyrave Casati (Overline), me tri shtresa ngjyrë, ngjyra është pa shkëlqim (mat), me përbërje akrilike, depërtueshmëri avulli dhe uji shumë të mirë, rezistent i mirë, i mundshëm pastrimi i tij me leckë të lagët. Ngjyrat janë përcaktuar nga ana e arkitektit dhe në mënyrë strikte do punohën sipas përzgjedhjes.	m²	4,220.00	0.50 €	2,110.00 €
TOTALI POSICIONI 1.10:					2,110.00 €
1.11. PUNËT E DYSHEMESE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali



1.11.1	Furnizimi me material dhe vendosja e dyshemesë nga materiali "NORAPLAN STONE", me trashësi t = 2.5mm, rrolle me dimensione 1.22x15m. Në fillim duhet të shtohet me bazë primar "UZIN PE 360, nivelizuesit të dyshemesë "UZIN NC-145" dhe ngjites goma "UZIN KE-2000 S" dhe në fund me material "NORAPLAN CLASSIC". (Veretjet si pozicion mund të punohet edhe linoieum ose epoxyd te kualitet te larte. Por gjithmone ne bashkepunim me arkitektin dhe organin mbikqyresj.	m ²	2,055.00	16.00 €	32,880.00 €
TOTALI POSICIONI 1.11					32,880.00 €



1.12. PUNËT E PILAFONIT TË LËSHUAR					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.12.1	Furnizimi me material dhe montimi i pilafave të Armstrongut të prodhuesit "LAFARGE", me dimensione 600x600x14mm, me të gjithë aksesorët për gjatësi, perimetri dhe varëse. Të gjitha pilafonet tjera përpos amfiteatrit do jenë të punuara me këtë llojë Armstrongu dhe i cili do jetë i përcaktuar nga arkitekti. Në përshkrim teknik do të bashkangjesim dhe të dhënat e përgjithshme për të.	m ²	2,750.00	13.00 €	35,750.00 €
TOTALI POSICIONI 1.12:					35,750.00 €
1.13. PUNËT TJERA					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.13.1	Furnizimi dhe montimi i llajsneve në dysheme nga material i llojit në formë T, ku kemi dilatat të objektit.	m ²	24.00	25.00 €	600.00 €
1.13.2	Furnizimi dhe montimi i llajsneve në mure ku kemi dilatat në objektin në muret e brendshme	m ²	45.60	25.00 €	1,140.00 €
1.13.3	Furnizimi dhe montimi i shkronjave mbi hyrjen e objektit.	paushall	2.00	250.00 €	500.00 €
1.13.4	Furnizimi dhe punimi i shkallëve emergjente të cilat do të punohen nga profilet metalike. Verejtje: Saldimet e profileve metalike dhe punet tjera me saldim duhet të punohen nga punonjes të specializuar dhe të certifikuar me certifikat IW5 (International welding specialist)	paushall	1.00	3,000.00 €	3,000.00 €
1.13.5	Furnizimi dhe muratimi i oxhakëve me tullë fasade, si dhe mbështjellja me llamarinë.	m ²	13.00	45.00 €	585.00 €
1.13.6	Furnizimi dhe mveshja e mureve me plumbë në sallën e rregullit, e cila shërbenë për mbrojtje nga rrezatimi.	m ²	150.00	45.00 €	6,750.00 €
1.13.7	Furnizimi dhe montimi i xhamit nga plumbi me dim. 400x340 cm, e cila shërbenë për mbrojtje nga rrezatimi. Ky pozicion është në sallën e rregullit	Copë	1.00	2,000.00 €	2,000.00 €
1.13.8	Furnizimi dhe punimi i mbulesës të kulmit të shkallë për bodrum nga konstrukcioni me profile metalike -shtyllat dhe profili i cili inkastruar në muri 60x60 mm, -trajet primare dhe sekundare 40x40 mm. Në çmim të parashihet ngjyrosja e profileve metalike me ngjyrë kundër korezionit, dhe ngjyrosen me ngjyrë adekuatë për profile metalike në nuancë hiri sikurse ngjyra e fasadës ventiluese. Në çmim poashtu parashihet edhe vendosja e ulukëve horizontal dhe vertikal nga llamarina e plastifikuar ngjyrë hiri	copë	1.00	1,700.00 €	1,700.00 €
1.13.9	Furnizimi dhe vendosja e mbulesës "Polikarbonat" me trashësi 2 cm mbi konstrukcionin me profile metalike ku perforimi bëhet me bulona adekuat dhe sipas normativave.	m ²	28.00	5.00 €	140.00 €
TOTALI POSICIONI 1.13:					16,415.00 €
1.14. PUNËT E ZDRUKHTYARISE- Dritaret (Alumin)					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.14.1	Furnizimi dhe montimi i dritareve të aluminit dhe fasades gjysëmstrukturale	copë	13.00	360.00 €	4,680.00 €

1.14.2	D2- 160 x 160 cm	copë	4.00	280.00 €	1,120.00 €
1.14.3	D3- 140 x 160 cm	copë	3.00	280.00 €	840.00 €
1.14.4	D4- 100 x 160 cm	copë	13.00	200.00 €	2,600.00 €
1.14.5	D5- 120 x 160 cm	copë	4.00	200.00 €	800.00 €
1.14.6	D6- 160 x 260 cm	copë	4.00	360.00 €	1,440.00 €
1.14.7	D7- 80 x 160 cm	copë	1.00	150.00 €	150.00 €
1.14.8	D8- 80 x 160 cm	copë	2.00	180.00 €	360.00 €
1.14.9	D9- 200 x 100 cm	copë	6.00	290.00 €	1,740.00 €
1.14.10	D10- 140 x 100 cm	copë	3.00	200.00 €	600.00 €
1.14.11	D11- 400 x 160 cm Panell i Qelqit (fasada gjysemstrukturale) me profile Alumini me urë Termike dhe me xham Termopan 4x16x6. Korniza këndore e salduar dhe e fiksuar me vinda.	copë	8.00	100.00 €	800.00 €
1.14.12	D12- 400 x 200 cm Panell i Qelqit (fasada gjysemstrukturale) me profile Alumini me urë Termike dhe me xham Termopan 4x16x6. Korniza këndore e salduar dhe e fiksuar me vinda.	copë	4.00	100.00 €	400.00 €
1.14.13	D13- 1100 x 200 cm Panell i Qelqit (fasada gjysemstrukturale) me profile Alumini me urë Termike dhe me xham Termopan 4x16x6. Korniza këndore e salduar dhe e fiksuar me vinda.	copë	1.00	100.00 €	100.00 €
1.14.14	D14- 360 x 160 cm	copë	3.00	100.00 €	300.00 €
	Furnizimi dhe montimi i Derës me profile Alumini me urë termike dhe me xham Termopan 4x14x4.				
1.14.15	d1- 260 x 260 cm	copë	4.00	580.00 €	2,720.00 €
	Furnizimi dhe montimi i Dyerve të brendshme medlapan me trashësi t=4 cm, korniza metalike sipas dimensioneve (trashësisë së murit), ngjyra e bardhë.				
1.14.16	d2- 150 x 205 cm	copë	1.00	150.00 €	150.00 €
1.14.17	d3- 110 x 205 cm	copë	11.00	120.00 €	1,320.00 €
1.14.18	d4- 120 x 205 cm	copë	45.00	120.00 €	5,400.00 €
1.14.19	d5- 120 x 205 cm (handikap)	copë	3.00	120.00 €	360.00 €
1.14.20	d6- 80 x 205 cm	copë	10.00	100.00 €	1,000.00 €
1.14.21	d7- 70 x 205 cm	copë	15.00	100.00 €	1,500.00 €
1.14.22	d8- 180 x 205 cm	copë	6.00	200.00 €	1,200.00 €
1.14.23	d9- 90 x 220 cm (emergjente)	copë	1.00	180.00 €	180.00 €
1.14.24	d10- 150 x 205 cm (kthina e nxemjes)	copë	1.00	220.00 €	220.00 €
1.14.25	d11- 180 x 205 cm (kthina e rënganit)	copë	1.00	250.00 €	250.00 €
TOTALI POSICIONI 1.14:					30,230.00 €

1.15. PUNËT E PARTERIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.15.1	Gërmimi i dheut të kategorisë së III-IV, me thellësi mesatare h=50 cm dhe transporti i dheut të tepërt deri në dëponinë e caktuar nga investitori.	m ³	1,650.00	0.60 €	990.00 €
1.15.2	Furnizimi me material, shtrirja dhe ngjeshja e materialit mbushës me trashësi t=30 cm me zhavor 0-150mm. Në pjesën ku do të shtrohet farbetoni.	m ³	780.00	5.00 €	3,900.00 €
1.15.3	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorrit 0-63mm, t=20cm, në sipërfaqen ku do të shtrohet kubezat.	m ³	510.00	4.00 €	2,040.00 €
1.15.4	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorrit 0-31mm, t=10cm, në sipërfaqen ku do të shtrohet kubezat.	m ³	260.00	5.00 €	1,300.00 €
1.15.5	Furnizimi me material dhe shtrimi i rërës 0-4 mm me trashësi t=5 cm për bazën e kubëzave.	m ³	160.00	6.00 €	960.00 €
1.15.6	Furnizimi me material dhe shtrimi i kubëzave të betoni me trashësi t= 8 cm, të qëndrueshme ndaj ngricave, me formë drejtëkëndëshi.	m ²	1,400.00	7.00 €	9,800.00 €



1.15.7	Furnizimi dhe punimi i betonit të thatë me armature rrjete të brinjëzuar Q 358 për shtruarjen e pllakave terraco me trashësi t=7 cm të klases C16/20	m ²	90.00	40.00 €	3,600.00 €
1.15.8	Furnizimi dhe montimi i pllakave terraco njështrësore e mermert me granulat kuarsi, diabazi, bazalti etj. format 60x40x5 cm të prodhuara me sistem hermetik të makinerisë. E testuar sipas EN 13748-2 E rrezuar dhe imregnuar për rezistencë nga UV me efekt easy clean, ngjyra të përcaktohet nga organin mbikqyrës. Produkti duhet të ketë teha të gryera "chamfer". Produkti duhet të ketë aditiv kundër kriprave sipas standardit EN. Sqarim : Për vendosjes duhet të sillët qartifikata e prodhuesit dhe atestat	m ²	1,200.00	10.00 €	12,000.00 €
1.15.9	Furnizimi me material dhe vendosja e gurëve skajor të betonit 10x24 cm të qëndrueshem ndaj ngricave. Në këtë pozicion të llogaritet edhe betoni për vendosjen e gurëve.	m ²	550.00	5.00 €	2,750.00 €
1.15.10	Furnizimi, rrafshimi i dheut të huazuar për mbijelljen e barit dhe rregullimin e hapësirave gjelberuese.	m ²	2,680.00	0.50 €	1,340.00 €
1.15.11	Furnizimi dhe mbijellja e drunjeve dekorativ.	copë	80.00	10.00 €	800.00 €
1.15.12	Furnizimi dhe vendosja e ulësve.	copë	36.00	55.00 €	1,980.00 €
1.15.13	Punimi i shenjësimit horizontal të parkingjeve me ngjyrë të bardhë, me vijë të plotë me gjatësi L=5 m dhe trashësi të vijës t= 12 cm.	m ²	360.00	1.00 €	360.00 €
1.15.14	Punimi i vendkalimeve të këmbësorëve. Vendkalimet do të shenjëzohen me shirita me ngjyrë të bardhë.	m ²	85.00	3.00 €	255.00 €
1.15.15	Furnizimi me material dhe punimi i rrethojës nga profilet metalike sipas detajit të prezantuar në projekt. Në këtë pozicion duhet të përfshihet edhe punimi i dyerve hyrëse, me gjatësi 7.5m. Themelet janë shëritore me dimensione 30x60 cm. Qmimi është llogaritur me m ² duke e përfshirë betonin e armuar, rrethojën.	m ²	300.00	30.00 €	9,000.00 €
1.15.16	Furnizimi me material dhe punimi i murit mbrojtës nga betoni i armuar, muri ka lartësi h=140 cm dhe gjerësi d=25 cm. Në këtë pozicion është përfshirë zhavorrit, armimi dhe betonimi i murit (të gjitha fazat e nevojshme për punimin e murit mbrojtës).	m ²	75.00	35.00 €	2,625.00 €
TOTALI POSICIONI 1.15:					53,700.00 €

1.16. PUNËT E ASHENSORIT

	Përkirimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Cmimi	Totali
1.16.1	Furnizimi dhe montimi i ashensorit me dimensione 1750x2900 mm, kapacitet 1250 kg për 3 atazhe, me motor Axiš 11 kw me kontrollim të shpejtësisë 1 m/s, dyert Automatikë të Inox-it 900x2000, kabina inox dyshemeja gomë e zezë në kabinë ndodhet pasqyra, pano elektronike 15 kw me LG ML60X DHE USB kur ndalet rryma ashensori zbret në katin më të afërt; Butonat e kateve wiserol LSTW 351 LSD dhe butonat e kabinës LSPN 2000 LSD, shinat e kabinës 90x75x16 mm shinat e kundër pesh 50x50x5, sajllat izmit çelik 10x5. Ashensori punohet me materiale sipas standardëve evropiane CE-ISO 9001-2000.	copë	1.00	17,500.00 €	17,500.00 €
TOTALI POSICIONI 1.16:					17,500.00 €



1.1. PUNËT E FASADËS	41,105.00 €
1.2. PUNËT E SUVATIMIT (mailterit)	14,250.00 €
1.3. PUNËT E NIVELIZIMIT	15,402.00 €
1.4. PUNËT E HIDROIZOLIMIT TEK SANITARIJET	1,860.00 €
1.5. PUNËT E QERAMIKAVE	22,940.00 €
1.6. PUNËT E MERMERIT	1,320.00 €
1.7. PUNËT E GILINDERAVE	3,825.00 €
1.8. PUNËT E GRANITIT	7,130.00 €
1.9. PUNËT E GLETIMIT (suvatimi me glet)	14,300.00 €
1.10. PUNËT E NGJYRES	2,110.00 €
1.11. PUNËT E DYSHEMESE	32,880.00 €
1.12. PUNËT E PLLAFONIT TË LËSHUAR	35,750.00 €
1.13. PUNËT TJERA	16,415.00 €
1.14. PUNËT E ZDRUKHTARISE -Dritaret (Alumin)	30,230.00 €
1.15. PUNËT E PARTERIT	53,700.00 €
1.16. PUNËT E ASHENSORIT	17,500.00 €
TOTALI:	310,717.00 €



2. ELEKTROINSTALIMET

2.1. RRYMA E FORTË

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
2.1.1	Kabllloja furnizuese nga trafostacioni Blind deri tek dollapi kryesor DEK me ane të kablllos NYY-J 4x150mm ² (Al) i futur në gyp të brinjëzuar, mbajtesë i metalt i kablllos gjatë tejdepërimit deri të DEK në bodrum .Ketu përshihet 3 puseta (2x2x2)m ,2 gypa të brinjëzuar Ø 160 ,hapja dhe mbyllja e kanalit me dimensione 0.4x0.9,shtrirja e shtresës së zhavorit prej 10cm nën dhe mbi kabell,mbrojtësi Gal dhe shiriti paralojmerues.	m	100.00	30.00 €	3,000.00 €
2.1.2	Kabllloja furnizuese nga Gjeneratori deri tek dollapi kryesor DEK me ane të kablllos NYY-J 4x150mm ² (Al) i futur në gyp të brinjëzuar .Ketu përshihet hapja dhe mbyllja e kanalit me dimensione 0.4x0.9,shtrirja e shtresës së zhavorit prej 10cm nën dhe mbi kabell,mbrojtësi Gal dhe shiriti paralojmerues.	m	50.00	5.00 €	250.00 €
2.1.3	Kabllloja furnizuese nga dollapi kryesor DEK deri tek gjeneratori -per ngacimim me ane të kablllos NYY-J 4x10mm ² (Cu) i futur në gyp të brinjëzuar .Ketu përshihet hapja dhe mbyllja e kanalit me dimensione 0.4x0.9,shtrirja e shtresës së zhavorit prej 10cm nën dhe mbi kabell,mbrojtësi Gal dhe shiriti paralojmerues.	m	50.00	3.00 €	150.00 €
2.1.4	Kabllloja furnizuese nga dollapi kryesor DEK deri tek ashensori dhe me ane të kablllos PP-Y(NYM) 5x16mm ² (Cu) i futur në gyp të brinjëzuar	m	20.00	8.00 €	160.00 €
2.1.5	Kabllloja furnizuese nga dollapi kryesor DEK deri tek dollapi kryesor DEK-QILERI me ane të kablllos PP-Y(NYM) 4x50mm ² +1x35mm ² (Cu) i futur në gyp të brinjëzuar	m	25.00	17.00 €	425.00 €
2.1.6	Kabllloja furnizuese nga dollapi kryesor DEK deri tek tabelat shpërndarëse TSH1,TSH2,TSH3,TSH4,TSH5,TSH6 me ane të kablllos PP-Y(NYM) 5x16mm ² (Cu)-te futur në gyp të brinjëzuar	m	180.00	12.00 €	2,160.00 €
2.1.7	Kabllloja furnizuese nga ormani DEK deri tek ormani DER-radiologji PP-Y(NYM) 5x35mm ² (Cu) i futur në gyp të brinjëzuar	m	30.00	15.00 €	450.00 €
2.1.8	Kabllloja furnizuese nga ormanat e klima komorës deri tek qilerit 1 (per komandim) me ane të kablllove 4x(NYY-J) 5x2.5mm ² (Cu)te futur në gyp të brinjëzuar	m	20.00	10.00 €	200.00 €
2.1.9	Kabllloja furnizuese nga dollapi kryesor shpërndarës DEK deri tek deri tek tabelat e siguresave (TSH1 -TSH6) -(mundesia e lidhjes me UPS) me ane të kablllos PP-Y 5x6mm ² (Cu) te futur në gyp të brinjëzuar	m	180.00	4.00 €	720.00 €



2.1.10	Porosia dhe vendosja e ormanit kryesor shpërndarës DEK me dimensione(axbxc) i vendosur në perdhës. Ormani duhet të përmbajë: 2 nderprerës AS 250A, Grupin mates të kompletuar me 3 transformator të rrymës 200/5A, me orën SA dhe ndruesin tashor, 3 voltmetra, 8 komplete të siguresa 63A me baza të saj, 6 komplete të sigursave 32A me baza të saj, 2 komplete të siguresa 100A, 125A me baza të saj, 6 nderprerës DPX 80A, 2 nderprerës DPX 160A 3 shkarkues të mbitemensioneve 4xP.K 0.38/0.5, 2 kontaktor 200A për lidhje paralele të gjeneratorit. Ormani duhet të përmbajë edhe materialin përcjelles si: Zbarrat, termotkurset, përquesit lidhës, Shiritin për tokezim të ormanit si dhe materialin për kompletim të tij.	cope	1.00	1,700.00 €	1,700.00 €
